Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet publike, universitetet, partnerët ndërkombëtarë, artistë të shquar, shpikës, biznese, ish drejtues të DPPI-së, dhomat e tregtisë dhe përfaqësues të autorizuar. Pjesë e paneleve të kësaj konference ishte dhe Dhoma Amerikane e Tregtisë nëpërmjet Presidentit të saj, z. Mark Kroford.

Në panelin kryesor të kësaj konference ishte z. Elton Haxhi, zëvendësministër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë, i cili prezantoi politikën dhe strategjinë kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016 - 2020. Z. Elvin Lako, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, duke folur për punën e institucionit që ai drejton tha:

"Në këto vitet e fundit, qëllimi ynë kryesor ka qenë rritja e cilësisë së shërbimit në standarde bashkëkohore për regjistrimin e objekteve

të pronësisë industriale dhe mbrojtjes së tyre në Republikën e Shqipërisë. Arritja e këtij qëllimi kërkoj reformimin e sistemit të Pronësisë Industriale, reformë e cila nisi që prej vitit 2015. Kjo reformë konsistoi në hartimin e strategjisë, përmirësimin e bazës ligjore dhe shërbimeve që DPPI-ja ofron si edhe forcimin e kapaciteteve administrative.

Në mars të vitit 2017, hynë në fuqi ndryshimet në ligjin Nr. 9947, "Për Pronësinë Industriale". Ndryshimet ligjore u hartuan në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë si Zyra Europiane e Patentave, Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale, Zyra e Pronësisë Intelektuale e Bashkimit Europian si dhe Delegacioni i KE-së në Shqipëri.

Pjesë e panelit të dytë ishte edhe z. Mark Kroford, President i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri.

Prezantimi i tij kishte të bënte me rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale dhe ndalimin e piraterisë për veprat artistike. Ai theksoi se sa i rëndësishëm është roli i IP-së për nxitjen e krijimtarisë dhe inovacionit.

Për të ilustruar respektimin e elementëve të IP-së, z. Kroford ka sjellë si shembull produksionin e një filmi që flet për Shqipërinë, ku shumë elementë kishin të drejtë të pronësisë industriale dhe intelektuale dhe shumë marka shqiptare u përfshinë në këtë film, duke iu njohur edhe të drejtat mbi filmin.

Rrugë për respektimin e të drejtave të autorit dhe pronësisë intelektuale është njëkalimshe" - tha Presidenti i Dhomës Amerikane z. Mark Kroford. Shqipëria duhet të forcojë pozitën ligjore dhe institucionale dhe duhet t'i respektojë patjetër këto të drejta, si një kusht themelor për thithjen e investimeve të huaja.

GJATË KONFERENCËS U NËNSHKRUA MEMORANDUMI I MIRËKUPITIMIT PËR BASHKËPUNIMIN ME ZYRËN HOMOLOGJE TË MAQEDONISË. KY MEMORANDUM U NËNSHKRUA NGA DREJTORËT E PËRGJITHSHËM TË TË DYJA ZYRAVE PËRKATËSE, Z. ELVIN LAKO, DREJTOR I PËRGJITHSHËM I DPPI-SË DHE Z. SAFET EMRULI, DREJTOR I PËRGJITHSHËM I ENTIT SHTETËROR TË PRONËSISË INDUSTRIALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.

Organizimi i kësaj konference është bërë tashmë traditë për DPPI-në. Ky është event i kryesor në kuadër të aktiviteteve promovuese të Pronësisë Intelektuale në Republikën e Shqipërisë.



AMCHAM MESSAGE FOR WORLD INTELLECTUAL PROPERTY DAY

April 26th was the World Intellectual Property Day. Over the years, the American Chamber of Commerce has engaged, alongside relevant institutions, in establishing and developing the proper legal framework for intellectual property.

On the World Intellectual Property Day, we join forces with all international and local institutions to provide the business with the required safe space, in which creative ideas and innovations are developed, respected and protected.

This year the World Intellectual Property Day has essentially in its core the promotion of women's role in innovation and creativity. Today more than ever distinguished women, who have brought about change and innovation over the years everywhere in the world, have the gratitude and respect of the entire business community for their engagement in this field. Brilliant, smart and challenging women who care for the business world, academia and creativity!

In respect of this contribution, through a Committee dedicated to them, the American Chamber pays the attention they so much deserve to women in business. It is not a coincidence that the Committees within the Chamber are mostly run by women, who themselves represent important businesses in the country.

On this day, we wish to take the opportunity to honor the driving and leading force of all those women, who with their courage, are bringing about change and shaping a better future for business, the economy and the country. Special respect goes today, to all our honored women members, who have supported us over the years. We truly thank you!



MESAZHI I AMCHAM-IT PËR DITËN NDËRKOMBËTARE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

26 prilli është Dita Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale. Dhoma është angazhuar përgjatë shumë viteve në krah të institucioneve përkatëse, për krijimin dhe zhvillimin e kuadrit ligjor në lidhje me pronësinë intelektuale.

Sot, në Ditën Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale bashkojmë forcat më të gjitha institucionet ndërkombëtare dhe ato lokale, për t'i ofruar biznesit hapësirën e sigurtë të nevojshme ku zhvillohen, respektohen dhe mbrohen idetë novatore dhe risitë në biznes.

Këtë vit, Dita Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale ka në thelb të promovimit të saj figurën e gruas në inovacion dhe krijimtari. Ndër vite, emra të mirënjohur të grave që kanë sjellë ndryshimin dhe novacionin kudo në botë, sot më shumë se kurrë marrin mirënjohjen dhe respektin nga i gjithë komuniteti i biznesit për angazhimin e tyre në këtë fushë. Gra brilante, të zgjuara dhe sfiduese që kujdesen për botën e biznesit, akademisë dhe krijimtarisë.



Në respekt të këtij kontributi, Dhoma Amerikane i kushon rëndësinë që meriton figura e gruas në biznes nëpërmjet një Komiteti të dedikuar për të. Nuk është e rastësishme që Komitetet në Dhomën Amerikane në pjesën dërrmuese drejtohen nga gra, të cilat gjithashtu përfaqësojnë emra të rëndësishëm të biznesit në vend.

Sot, Dhoma Amerikane gjen përsëri rastin të nderojë forcën drejtuese të të gjitha atyre grave që me kurajon e tyre po sjellin ndryshimin dhe po formatojnë një të ardhme më të mirë për biznesin, ekonominë dhe vendin.

Criteria and benefits for businesses

CUSTOMS AND IFC PROMOTE THE AUTHORIZED ECONOMIC OPERATOR STATUS

Albania's General Customs Directorate (GCD), in cooperation with IFC, launched an information campaign to promote awareness among economic operators performing cross-border transactions on the benefits stemming from acquiring the Authorized Economic Operator (AEO status) and the criteria that must be met to be receive the status.

The Customs administration has held dedicated meetings in Vlora and Tirana, and the GCD Deputy Director, Mirela Melko, shared with business representatives that the aim is to make it easier for companies to operate through customs, to get timely clearance and to increase service standards.

Focusing on the elements that constitute the status allocation process, Allen Bruford, an IFC expert, noted that one of the fundamental policies of the World Customs Organization and its "21st Century Customs" initiative is a partnership between customs and businesses. It is one of the ten basic units spelled out as defining the strategic direction.

The American Chamber of Commerce in Albania is working together with the customs administration to provide information to AmCham members that work with customs about the opportunities and benefits that the AEO status offers.

The Authorized Economic Operator status is granted to trustworthy economic operators after they meet a set of defined criteria. The status makes it a lot easier to do business through customs facilities. The status is granted to economic operators based in Albania and which meet the established criteria.



Criteria the operator must meet

.....

- Conforming and showing significant compliance with customs and tax legislations;
- Having an efficient system of trade and transport data management;
- Being in good financial health and solvency;
- Having practical standards of professional qualifications or competencies – OEAD;
- Having appropriate standards of security and protection - OEAS.

The benefits that stem from having the AEO status

.....

- More favorable treatment with regards to risk assessment and controls, fewer physical and document checks than other economic operators;
- Easier procedures for pre-departure statements;
- When deliveries declared by an OEA are selected for a physical or paperwork examination, such checks must be carried out with priority;
- At the request of an AEO, checks can be carried out at a different place from where the goods are first declared at customs;
- Convenience and other benefits when getting authorizations for simplification of customs procedures.

Kriteret dhe përfitimet që vijnë për biznesin

DOGANAT DHE IFC PROMOVOJNË STATUSIN E OPERATORIT EKONOMIK TË AUTORIZUAR



Drejtoria e Doganave në bashkëpunim me IFC-në kanë filluar një fushatë të informimit dhe ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë që shkelin kufirin doganor, për t'i njohur me lehtësitë dhe benefitet që iu vijnë nga përfitimi i statusit të operatorit ekonomik.

Duke folur për qëllimin e takimeve që Drejtoria e Doganave ka mbajtur në Vlorë dhe në Tiranë, Zëvendësdrejtoria e Doganave Mirela Meko u shpreh se qëllimi i doganave është të lehtësojë punën e biznesit, kohën e zhdoganimit dhe të rrisë standardin e shërbimit. Duke u fokusuar më shumë tek elementët që përbëjnë procesin e akordimit të këtij statusi, Allen Bruford, ekspert i IFC-

së ka kujtuar faktin se një nga politikat themelore të Organizatës Botërore të Doganave për “Doganat e Shekullit 21” është partneriteti dogana – biznes, si një nga dhjetë njësitë themelore të përcaktimit të drejtimit strategjik.

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka bashkëpunuar me doganat për të informuar anëtarët e saj të cilët kanë veprimtari doganore, për mundësinë që iu jepet nga përfitimi i statusit. Operatori Ekonomik i Autorizuar është statusi që përfitojnë operatorët ekonomikë të besueshëm kundrejt përmbushjes së një sërë kriterëve të përcaktuara, të cilët mund të përfitojnë nga shumë thjeshtime apo lehtësi doganore. Këtë status e përfiton një operator ekonomik, i cili është i vendosur në territorin doganor të vendit tonë dhe që i përmbush kriteret e vendosura.




Kritere që duhet të plotësojë operatori

Kriteret e konformitetit, pajtueshmërisë me legjislacionin doganor dhe tatimor
Disponon një sistem efikas të menaxhimit të të dhënave tregtare dhe të transportit
Aftësi të mira paguese financiare
Standardet praktike të kompetencave ose kualifikimet profesionale - OEAD
Standardet e duhura të sigurisë dhe mbrojtjes - OEAS

Lehtësitë dhe përfitimet që rezultojnë nga statusi OEA

Trajtim më i favorshëm për sa i përket vlerësimit dhe kontrollit të riskut, më pak kontrole fizike dhe dokumentare sesa operatorët e tjerë ekonomikë
Lehtësitë lidhur me deklaratat e paranisjes
Kur dërgesat e deklaruara nga një OEA janë përzgjedhur për një kontroll fizik apo dokumentar, këto kontrole duhet të kryhen me prioritet
Me kërkesë të një OEA-je kontrollet mund të kryhen në një vend tjetër të ndryshëm nga vendi ku mallrat duhet të paraqiten në doganë
Lehtësi dhe përfitime nga autorizimet për thjeshtëzime doganore

LEADER FOR A DAY



At the end of April, I had the great pleasure of hosting for a day, a brilliant Sami Frasher student, Klearta Shira, as part of the Leader for a Day Junior Achievement (JA) Program, an AADF-funded project, which enables students to learn from a leader by shadowing him/her for a day. The aim is to cultivate a new generation of leaders, empower young people to make informed career choices and enlarge their network. It is the second year in a row that AmCham hosts such a talent in the 6 editions of the program conducted by JA.

Klearta had the opportunity to align closely and learn from the AmCham very active executive team as well, being exposed during the day to a comprehensive overview of the roles, functions, responsibilities and activity of AmCham. As to enhance her experience, she was also hosted by an AmCham Board Member, Dael Dervishi, as part of his engagement with McCain Institute for International Leadership.

We are also very proud that out of 48 business leaders shadowed this year, 21 of them were distinguished AmCham members, who hosted a student for a day (random listing): US Embassy, AADF, Sigal Uniq Group Austria, Creative Business Solutions, Telekom Albania, DM Consulting Services, Gener 2, ATOM Computers, Antea Cement, NOA, Intesa SanPaolo Bank, Tirana Bank, Credins Bank, Lufthansa Albania, Balfin Real Estate, Easy Pay, International Commercial Bank, ProCredit Bank, Vodafone Albania, Teuta and World Vision Western Balkan.

THIS WAY TOGETHER WE CONTRIBUTE TO OPENING UP PERSPECTIVES FOR THE FUTURE LEADERS OF THE COUNTRY.


DREJTUES PËR NJË DITË

Në fund të prillit, pata kënaqësinë e madhe të mirëpres për një ditë, një studente të shkëlqyer të gjimnazit “Sami Frashëri”, Klearta Shira, si pjesë e Programit Drejtues për një Ditë e Junior Achievement (JA), një projekt i financuar nga AADF, i cili u jep mundësi studentëve të mësojnë nga një lider, duke ndjekur për një ditë praktikën e tyre të punës. Qëllimi i programit është kultivimi i një brezi të ri drejtuesish, fuqizimi i të rinjve për t'i bërë ata të aftë të bëjnë zgjedhje karriere të mirëinformuara si dhe zgjerimi i rrjetit të tyre të kontakteve. Është viti i dytë radhazi që AmCham-i mirëpret një talent të tillë në 6 edicionet e programit të zhvilluara nga JA.

Klearta pati mundësinë të ndjekë nga afër dhe të mësojë gjithashtu nga ekipi ekzekutiv shumë aktiv i AmCham-it, duke marrë gjatë ditës një pasqyrë të plotë të roleve, funksioneve, përgjegjësi dhe veprimtarisë së AmCham-it. Për ta pasuruar eksperiencën e saj në këtë ditë, ajo u prit gjithashtu edhe nga një anëtar i Bordit të AmCham-it, Dael Dervishi, si pjesë e angazhimit të tij me Institutin McCain për Leadershipin Ndërkombëtar.

Ne jemi shumë krenarë që nga 48 drejtues të përzgjedhur këtë vit, për të pritur një student për një ditë, 21 prej tyre ishin anëtarë të respektuar të AmCham-it: Ambasada Amerikane, AADF, SIGAL Uniq Group Austria, DM Consulting Services, ATOM Computers, Banka Intesa Sanpaolo, Banka e Tiranës, Banka Credins, Lufthansa Group Albania, Balfin Real Estate, Easy Pay, CBS Creative Business Solutions, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Telekom Albania, Banka ProCredit, Vodafone Albania, Gener 2, Antea Cement, Teuta Durrës dhe World Vision për Ballkanin Perëndimor.

KËSHU, SË BASHKU NE KONTRIBUOJMË NË KRIJIMIN E PERSPEKTIVAVE PËR DREJTUESIT E ARDHSHËM TË VENDIT.



ANTI-CORRUPTION BUSINESS COALITION



The International Chamber of Commerce (ICC) in Albania, with the support of the Embassy of the Kingdom of the Netherlands in Albania, has embarked on a project to establish an Anti-Corruption Business Coalition by September, through a project, otherwise called the ABC Project.

The goal of the project is to promote an attractive business climate through good governance, advocate for endorsement of best international integrity practices and strengthen the capacities of the public and private institutions, which are instrumental in the fight against corruption.

Mid May saw an event organized by ICC and the Embassy of the Kingdom of the Netherlands bring together all the potential private sector members of the Coalition, along with representatives of the government and international Think Tanks to brainstorm how to establish an effective coalition.

IDEAS THAT WERE INTRODUCED ENTAILED INCORPORATION OF THE ICC CLAUSE ON CORRUPTION INTO CONTRACTS, ADOPTION OF OECD GUIDELINES AND WAYS TO PUSH THE GOVERNMENT TO BE MORE ACCOUNTABLE.

Best international practices shared showed that corruption is a costly business, thus, fight against it requires involvement by all and engagement with the government and encouragement of the businesses to openly share their concerns. The state is expected to create a legislative environment that promotes level playing field with no compromise on anti-corruption agendas/clauses. Marking of companies through an anti-corruption listing and introduction of a solid Code of Conducts and Compliance functions in each business entity was also strongly encouraged. Practice has shown that being non-corrupt is a competitive business proposition but one needs to remember that integrity is not a point in time you get to, but something that you should work at constantly.

As effective practices, were proposed a series of events to be organized in the first 10 days of December by the private sector actors and culminate this ini-

tiative with a bigger event on December 9, which marks the International Day on Anti-Corruption.



AMCHAM HAS EMBRACED THIS INITIATIVE PROACTIVELY. A NUMBER OF OUR MEMBERS ANSWERED THE CALL TO JOIN THIS EVENT, AS SUPPORTERS OF THIS ANTI-CORRUPTION COALITION.

AS PART OF ITS BUSINESS AGENDA TO HELP BUSINESS DEVELOP FURTHER AND FIGHT CORRUPTION, AMCHAM JOINS FORCES WITH THE UNITED STATES EMBASSY AND ITS INTERNATIONAL AND LOCAL COUNTERPARTS AS THEY IMPLEMENT THE ONGOING JUDICIAL REFORM PROCESS. AMCHAM HAS ELEVATED ITS HR COMMITTEE BY ADDING AN ETHICS IN BUSINESS COMPONENT TO IT AND HAS PUT IN PLACE A MORE ELABORATE CODE OF CONDUCT REQUIRING ITS MEMBERS TO IMPLEMENT IT AS WELL. AMCHAM IS ALSO PARTICIPATING ACTIVELY WITH FEEDBACK IN ROUNDTABLES ORGANIZED BY THE MINISTRY OF JUSTICE, AS THE NATIONAL COORDINATOR FOR ANTI-CORRUPTION ACTION, PROMOTING INVOLVEMENT OF THE BUSINESS SECTOR/ORGANIZATIONS IN ANY GOVERNMENT ACTIONS, AS COORDINATED EFFORTS ARE ALWAYS MOST EFFECTIVE.

KOALICIONI ANTI-KORRUPSION I BIZNESIT

Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC) në Shqipëri, me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Hollandës, ka ndërmarrë një projekt për krijimin e Koalicionit Anti-Korrupsion të Biznesit në shtator, përmes një projekti, të quajtur Projekti ABC.

Qëllimi i projektit është të promovojë një klimë tërheqëse biznesi nëpërmjet qeverisjes së mirë, të llojë për miratimin e praktikave më të mira ndërkombëtare të integritetit të korporatave dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve publike dhe private në Shqipëri, të cilat janë të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit.



Qëllimi kryesor i projektit është krijimi i një koalicioni të gjerë me pjesëmarrjen e anëtarëve të ICC Albania, organizatave të biznesit, si AmCham, akademisë, organizatave ndërkombëtare në Shqipëri dhe sektorit të biznesit. Qëllimi është që ato të përfshihen në një dialog të vazhdueshëm për të trajtuar çështje specifike që sigurojnë qeverisje të mirë të korporatave.

Mesi i majit u shënjua nga event i organizuar nga ICC Albania dhe Ambasada e Mbretërisë së Hollandës, i cili mbledhi të gjithë anëtarët potencialë të sektorit privat të koalicionit, së bashku me përfaqësuesit e qeverisë dhe një grup ekspertësh ndërkombëtarë, për të ideuar krijimin e një koalicioni efikas.

IDETË QË U PREZANTUAN PËRFSHININ PREZANTIMIN E KLAUZOLËS SË ICC-SË MBI KORRUPSIONIN NËPËR KONTRATA, MIRATIMIN E UDHËZIMEVE TË OECD-SË DHE MËNYRAT PËR TË NXITUR QEVERINË TË JETË MË E PËRGJEGJSHME.

Praktikat më të mira ndërkombëtare treguan se korrupsioni është një biznes i kushtueshëm, ndaj lufta kundër tij kërkon një përfshirje nga të gjithë si dhe koordinimin me qeverinë dhe inkurajimin e bizneseve për të ndarë hapur shqetësimet e tyre. Shteti duhet të krijojë një mjedis legjislativ që promovon një mjedis operim të barabartë, pa kompromentuar asnjë axhendë anti-korrupsionit.

U inkurajua fuqimisht dhe ideja e vlerësimit dhe renditjes së kompanive në një listë anti-korrupsion dhe prezantimi i Kodit të Etikës dhe Funksioneve të Pajtushmërisë në secilën njësi biznesi. Praktika ka treguar se të qenit jo i kor-



ruptuar e bën biznesin më konkurrues, por duhet mbajtur mend se integriteti nuk është një pikë e caktuar në kohën ku çdonjëri nga ne duhet të mbërrijë, por diçka për të cilën të gjithë duhet të punojmë vazhdimisht.

Si praktika efikase, u propozuan një sërë eventesh që do të organizohen në 10 ditët e para të dhjetorit nga aktorët e sektorit privat. Kjo iniciativë pritet të kulmojë me një event të madh, i planifikuar të organizohet më 9 dhjetor, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Anti-Korrupsionit.

DHOMA AMERIKANE E KA PËRQAFUAR KËTË NISMË. NJË NUMËR I KONSIDERUESHËM I ANËTARËVE TANË IU PËRGJIGJËN THIRRJES PËR T'JU BASHKUAR KËTIJ EVENTI, SI MBËSHTETËS TË KOALICIONIT ANTI-KORRUPSION.

SI PJESË E AXHENDËS SË VET TË BIZNESIT, PËR TË NDIHMUAR BIZNESIN TË ZHVILLOHET MË TEJ DHE TË LUFTOJË KORRUPSIONIN, DHOMA KA BASHKUAR FORCAT ME AMBASADËN E SHTETEVE TË BASHKUARA DHE ME HOMOLOGËT E SAJ NDËRKOMBËTARË DHE VENDAS, NDËRSA ATO ZBATOJNË PROCESIN E VAZHUESHËM TË REFORMËS NË DREJTËSI. AMCHAM-I E KA FORCUAR KOMITETIN E VET TË BURIMEVE NJERËZORE, DUKE SHTUAR GJITHASHTU NJË KOMPLEMENT RISI, ATË TË ETIKËS NË BIZNES SI DHE KA PREZANTUAR NJË KOD SJELLJEJE, I CILI KËRKOHET TË ZBATOHET DHE NGA ANËTARËT E SAJ NËPËR BIZNESET E TYRE. AMCHAM PO MERR PJESË GJITHASHTU NË MËNYRË AKTIVE ME SUGJERIME NË TRYEZA TË RRUMBULLAKËTA TË ORGANIZUARA NGA MINISTRIA E DREJTËSISË, SI KOORDINATORE KOMBËTARE PËR AKSIONIN KUNDËR KORRUPSIONIT, DUKE PROMOVUAR PËRFSHIRJEN E SEKTORIT / ORGANIZATAVE TË BIZNESIT, PËR TA BËRË MË EFIKAS ÇDO VEPRIM TË QEVERISË, DUKE QENË SE VEPRIMET E PËRBASHKËTA JANË GJITHMONË MË EFIKASE.

PRIVATE PENSIONS:

IS THERE HOPE FOR A SOLUTION?



In Albania, the use of voluntary private pension plans is very low and currently only accounts for 0.05% of the GDP, or about 1% of all income from private insurance. Gross premiums deposited in voluntary private pensions for a 9-month period in 2017 amounted to a total of 11.91 million euros, while the number of fund members marked 20,223. These figures are very low compared to the region and Europe as a whole. They are also nowhere close to the weight this sector carried in a mature economy.

In the state pension system, the contributor-beneficiary ratio has seen a significant decline in the recent decades. The ratio of 4 contributors to 1 beneficiary seen in 1990 went down to 0.8 contributors to 1 beneficiary in 1997, and despite major efforts since then, contributors remained at the 1.1 limit per beneficiary, which means the state pension system, also known as the solidarity system, is not on solid ground.

The lack of proper functioning of the state system has led to it being in a deficit, relying on the state budget to stay afloat, which means it is not a sustainable system. Much of state pension system is paid out of the state budget (from taxes) -- in other words every year billions are paid out by the state to keep the system afloat as it is a failed system. Government initiatives for revamping

and improving the state pension system are without a doubt the right steps to move toward European standards, under which each should contribute for oneself and not others, but so far these initiatives have remained simply on paper and there have not been any concrete changes..

In the old state system, citizens and employers pay 21.6% (employer and employee contributions are divided into two parts, but deposited into one account, which is ultimately paid by the company) for state pension contributions, which are then allocated for the society as a whole instead of going directly to whoever pays those contributions into the system.

But even the so-called new pension reform, does not make a full three-pillar system functional, especially with a pillar, which deals with investing available contributions by the state into private systems. Under the current system, contribution to the private pension funds is fully dependant on the citizens' free will.

To escape from the current system, the new government reform envisages strengthening the three pillars: **compulsory contribution, voluntary contribution and private plans.**

But what is being done to develop these three pillars? What specifically will be done on drafting legal regulations for these reforms -- and more importantly, how will these reforms be implemented? What concrete steps will be taken to expand private pension plans?

The time has passed for simple discussions and proposals that are shelved by the institutions and get no external feedback.

It is time for private voluntary pension plans to become mandatory as part of a three-pillar pension system, like the one applied across the world.

Any employer or employee who reads this article will likely say: Why should I

pay more money?! **NO!**

THIS PROPOSAL IS NOT ASKING TO INCREASE THE CURRENT PERCENTAGE THAT IS LEGALLY BINDING, THE 21.6% CURRENTLY PAID AS PENSION CONTRIBUTION, BUT TO CHANGE THE SYSTEM SO THAT A PORTION OF THAT MANDATORY CONTRIBUTION CAN GO TO PRIVATE PENSION MANAGEMENT COMPANIES.

If even 1.6% of the contribution paid into the state system moves to the management of private insurance companies, there would be a better chance for contributors to get an old-age income supplement. That is the case for all contributors to the private system, be they voluntary or not, as such a contribution will be an investment in itself, and result at the time of retirement to a secondary private pension with higher benefits than the state will provide, and the benefits can kick in as early as at 60 years of age. That is how the system functions around the world. Albania does not need to reinvent the wheel. However, there is a lack of initiative.

We should give Albanian citizens the opportunity to have another system, where they can pay their contributions to social security.

So, transferring a percentage of the pension contributions, even a tiny one, from the administration of the state to that of private companies would allow for the emergence of private pension plans as a strong option, one that exists everywhere in the world, but one that is missing in Albania.

Otherwise, under existing private pension system, there is little added value as parallel to it, there are life insurance policies, which in addition to the huge advantage to society, allow each person to insure whatever amount they wish and on which they can then draw a monthly pension from their life insurance policy based on the insurance amount invested. One may choose the retirement age to receive this benefit as a monthly quota, in essence as a private pension, for example 500 euros

PENSIONET PRIVATE

A KA SHPRESË PËR ZGJIDHJE?

Në Shqipëri tregu i pensioneve private vullnetare është tejet i vogël, aktualisht zë vetëm 0.05% të GDP-së, ose rreth 1% të gjithë të ardhurave nga sigurimet private. Primet bruto nga pensionet private vullnetare për 9-mujorin e 2017-ës llogariten në 11.91 milionë euro, ndërsa numri i anëtarëve të fondit është 20.223 anëtarë. Shifra këto të papërfillshme jo vetëm në krahasim me rajonin apo Europën, por edhe për peshën që duhet të luajë ky sektor në ekonominë e vendit tonë.

Në skemën e pensioneve shtetërore, raporti kontribues-përfitues ka njohur një përkeqësim të dukshëm në dekadat e fundit. Ky raport nga 4 kontribues për 1 përfitues që ishte në vitin 1990, zbriti në 0.8 kontribues për 1 përfitues në vitin 1997, dhe gjithë vitet më pas, me gjithë sforcot e mëdha ka mbetur në kufirin 1.1 kontribues për 1 përfitues, ç'ka e vë në pozita jo të mira skemën shtetërore të pensioneve, ose ndryshe e njohur si skema e solidaritetit.

Ky keqfunksionim i skemës shtetërore ndër vite, ka bërë që të akumulohet një deficit i lartë në Buxhetin e Shtetit, për rrjedhojë e bën skemën financiarisht të papërbalueshme. Pjesa më e madhe e kësaj skeme paguhet nga Buxheti i Shtetit, (nga taksat tona), ose e thënë ndryshe çdo vite me miliarda lekë paguhet nga shteti pikërisht për shkak të mosfunksionimit të kësaj skeme. Iniciativa e qeverisë për rimodelimin dhe përmirësimin e kësaj skeme është pa dyshim një hap i drejtë për të shkuar drejt një standardi europian, ku secili duhet të kontribuojë për veten dhe jo për tjetrin, por deri më tani këto iniciativa kanë mbetur thjesht nëpër letra, duke mos u bërë asgjë konkrete.

Me skemën e vjetër shtetërore, qytetarët dhe punëdhënësit paguajnë 21.6% (kontributet e punëdhënësit dhe punëmarrësit ndahen në dy kolona, por derdhen në një llogari, që në fund të fundit është kosto e kompanive) për kontribute për pension, kontribute të

cilat shpërndahen për të gjithë shoqërinë dhe nuk shkojnë direkt tek ai që i paguan

Ka ardhur koha që fondet private të pensioneve vullnetare të bëhen të



kontributet.

Por edhe e ashtuquajtura reforma e re e pensioneve, nuk vë në funksion të plotë sistemin trekolonësh, sidomos kolonën e dytë, që ka të bëjë me investimet e kontributeve që disponon shteti në skemat private. Me skemën aktuale, fondet private funksionojnë në vullnetin e lirë të qytetarëve.

Për të shpëtuar nga kjo skemë, reforma e re e qeverisë parashikon forcimin e tre shtyllave:

**kontributin e detyruar,
kontributin vullnetar dhe
skemën private.**

Por çfarë po bëhet për zhvillimin e këtyre tri shtyllave? Çfarë konkretisht do të bëhet për hartimin ligjor të këtyre reformave dhe për më tepër a do të zbatohen këto reforma? Si do të zgjerohen konkretisht pensionet private?

Nuk duhet të mbetemi thjesht e vetëm tek diskutimet apo relacionet që mbeten sipër tavolinave të institucioneve, pa mundur të dalin jashtë atyre dyerve.

detyrueshme dhe skema me tre kolona e pensioneve të funksionojë sikundër ndodh në të gjithë botën.

Çdo punëdhënës apo punëmarrës që do të lexonte këtë shkrim do të thoshte: E pse duhet të paguaj ca para më tepër?! **JO!**

NUK ËSHTË FJALA PËR TË RITUR PËRQINDJEN AKTUALE QË ËSHTË E DETYRUESHME ME LIGJ, 21.6% QË PAGUHET AKTUALISHT PËR KONTRIBUTIN E PENSIONEVE, POR NGA KJO SHIFËR NJË PJESË TË KALOJË PËR MENAXHIM SHOQËRIVE PRIVATE TË PENSIONEVE.

Qoftë edhe 1.6% e këtij kontributi që derdhet në shtet të kalonte në administrimin e shoqërive private të sigurimeve, do të ishte një lehtësim dhe një mundësi më e mirë për të patur një të ardhur shtesë, një pension privat për të gjithë kontribuesit qoftë të detyruar qoftë vullnetar, sepse ky kontribut do të jetë një investim për vetë ata, të cilët në kohën e daljes në pension do ta marrin në formën e një pensioni të dytë privat me nivele shumë më të larta se në shtet, duke filluar nga mosha 60-vjeçare.



per month (depending on the amount that he or she has contributed over the years).

Changing the law to allow for a part of the compulsory contributions that employers pay to the state to go to the management of private pension funds will not entail any additional costs for the employer, the employee – and not even for the state itself.

This is because the employer and the employee will pay the same share of the pension contribution, but on the other hand, there will be a new alternative and further financial market development.

No matter how small the amount that can be required to be transferred to the private pension funds, it will create in one form or another a desire among citizens to increase individual investment and educate Albanians in the spirit of investment however small, all in their own interest and the growth their income.

Given the conditions in which Albania finds itself, it would be proper to have 3%-5% of the total contribution defined as a mandatory private contribution. This system works best under current conditions, seeing that the largest percentage of the GDP is coming from the private sector, with most taxes levied from it. As a result, the private sector should be given more weight than it currently has when it comes to pensions. **Secondly**, this system will best help the country's economy, making sure Albanians' money are invested in long-term financial instruments, 5-10-year bonds.

Thirdly, the system and the proposed legislative initiative should be in the context of reforms and harmonization of the legislation with the European Union. Like in any other area, social insurance reforms must take place in Albania as a pre-requisite for membership in the European family.

Private pension systems have a number of benefits and can help solve many problems, including the current labor market informality rate, which in Albania is very high.

The *de facto* functioning of the private pension system as part of a mandatory contribution system, in addition to voluntary participation, would solve the big problems of the past few years which have seen only older workers be willing to contribute. The private system would make younger workers more interested in investing in their pensions and would increase the current 1.1 contributor to 1 beneficiary ratio currently seen in the state plan.

On the other hand, it should be pointed out that the transfer of a portion of the contributions that citizens pay from the state to the private pension funds gives them two pensions, and ultimately the private pension is more favorable, because the benefits will be higher.

Likewise, the employee and the employer have legal benefits as these contributions would lower taxable income.

But the employees would not be the only ones to benefit. The employer would also gain through a reduced tax

on profits for the company, because contributions to private pensions from the employers can be used as a deductible for tax purposes. On the other hand, companies that decide to contribute to private pension funds on behalf of their staff also have benefits from reduction in taxes on earnings.

FOR EXAMPLE, IF AN EMPLOYEE HAS A GROSS SALARY 70,000 LEK PER MONTH AND DECIDES TO CONTRIBUTE 5,000 TO A PRIVATE PENSION FUND, THEIR SALARY WOULD BE TAXED AT THE 65,000 LEK LEVEL AND NOT THE 70,000 LEK, BECAUSE THE AMOUNT CONTRIBUTED TO THE PRIVATE PENSION IS DEDUCTED FROM THE TAXABLE INCOME. CONSEQUENTLY, THE TAX FOR THE 70,000 LEK PER MONTH SALARY WOULD BE 5,200 LEK PER MONTH, WHILE BEING TAXED AT 65,000 LEK IT WOULD BE 4,550 LEK PER MONTH. AS A RESULT, THE EMPLOYEE GETS TO KEEP AN EXTRA 650 LEK PER MONTH OR 7,800 LEK ANNUALLY.

IF WE TAKE THE EXAMPLE OF A SALARY THAT IS 100,000 LEK PER MONTH FOR AN EMPLOYEE, AND HE OR SHE DECIDES TO CONTRIBUTE 10,000 LEK TO A PRIVATE PENSION FUND, THEN THE TAX BENEFIT WOULD BE 1,300 LEK PER MONTH OR 15,600 LEK ANNUALLY.

AS FOR THOSE GETTING PAID 150,000 LEK PER MONTH AND WHO DECIDE TO CONTRIBUTE 20,000 LEK PER MONTH, THE ANNUAL BENEFIT ON TAXES WOULD BE 55,200 LEK.

For example, if a company with annual 500 million lek in revenue, and annual expenses of 300 million lek, decided that it would take 5 million lek to invest into a private pension fund on behalf of its staff, it would see its taxes decline by 750,000 lek.

The creation and development of private pension funds in Albania would be very effective because of the low average age of the population, currently at 33-35 years versus the 48-50 years in Europe. This means that the benefits from investments can be greater.

Albania now needs to lay the foundations of a diversified pension system, with both public and private pensions as critical parts, to contribute to the country's financial security. The key part of this system are private enterprises, especially the private insurance industry, which needs to be revitalized and supported by the state and not only seen as a source of tax money.

Sepse kështu është në të gjithë botën, nuk është asgjë e re për Shqipërinë, por këtu tek ne mungon iniciativa.

Duhet t'i japim mundësinë qytetarëve shqiptarë që të kenë edhe një alternativë tjetër për ato para që paguajnë si kontribute për sigurimet shoqërore.

Pra, heqja e një përqindjeje sado të vogël nga administrimi shtetëror i kontributeve të qytetarëve për pensionet dhe kalimi tek shoqëritë private, do të përligjte lindjen e pensioneve private si një alternativë zhvillimi, si një alternativë që ekziston kudo në botë, por vetëm tek ne mungon.

Ndryshe, me skemën ekzistuese pensionet private nuk kanë asnjë vlerë, sepse paralelisht me ato, madje me një avantazh më të madh, janë shoqëritë e sigurimit të jetës, në të cilat ke të siguruar edhe jetën por edhe mund të marrësh një pension mujor përsëri me sigurim jete dhe ku çdo person e zgjedh vetë shumën që do ta sigurojë jetën e tij dhe mënyrën se si do ta marrë këtë investim. Ai mund të zgjedhë që në moshën e daljes në pension këtë kontribut ta marrë si një kuotë mujore, pra si një pension privat, për shembull 500 Euro në muaj (në varësi të shumës që ka kontribuar ndër vite).

Ndryshimi ligjor ku një pjesë e kontributeve të detyrueshme që punëmarrësit paguajnë në shtet të kalojë nën administrimin e fondeve private të penioneve, nuk sjell asnjë kosto shtesë as për punëdhënësin, as për punëmarrësin dhe as për vetë shtetin. Kjo sepse punëdhënësi dhe punëmarrësi do të paguajnë të njëjtën kuotë të kontributit të pensioneve, por nga ana tjetër do të kemi edhe një alternativë zhvillimi të tregut financiar.

Sado e vogël të jetë kjo shumë, që do jetë e detyrueshme, ajo do krijojë në një formë apo tjetër dëshirën e qytetarëve për të rritur investimin individual dhe do edukojë tek shqiptarët frymën e investimeve sado të vogla në interes të tyre dhe të rritjes së të ardhurave të tyre.

Duke marrë parasysh kushtet në të cilat ndodhet Shqipëria, do të ishte e drejtë që 3%-5% e kontributit të përgjithshëm të përcaktohet si një kontribut i detyrueshëm privat. Kjo skemë është

më funksionalja momentalisht, pasi në Shqipëri përqindja më e madhe e GDP-së përbëhet nga taksat e vjelura nga sektori privat, ndaj duhet që sektori privat të vlerësohet shumë më shumë nga çfarë është aktualisht.

Së dyti, kjo skemë do të ndihmonte më mirë ekonominë e vendit, duke bërë që paratë e qytetarëve shqiptarë të investohen në instrumenta financiarë afatgjatë 5-10 vjeçarë (Obligacionet).

Së treti, kjo skemë dhe kjo nismë ligjore duhet të jetë në kuadër të reformave dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë europian. Reformat si në çdo fushë tjetër, duhet të jenë edhe në fushën e sigurimeve shoqërore, si një kusht i domosdoshëm për anëtarësimin në familjen europiane.

Sistemet private kanë një sërë përfitimesh si dhe i japin zgjidhje mjaft problemeve të kohës, një prej të cilave është edhe informaliteti i tregut të punës, i cili është në shifra të larta në vendin tonë.

Funksionimi 'de facto' i skemës private të pensioneve, si një skemë pjesërisht e detyrueshme dhe pjesa tjetër vullnetare, do të zgjidhte problematikën e madhe të këtyre viteve të fundit që është derdhja e kontributeve vetëm nga brezat e rritur. Skema private do ta bënte brezin e ri më të interesuar për të derdhur kontribute, ç'ka do të sillte edhe ndryshimin e raportit 1.1 kontribues me 1 përfitues që është aktualisht në skemën shtetërore.

Nga ana tjetër duhet të theksojmë, se kalimi i një pjese të kontributeve që qytetarët e derdhin në shtet, në fondet private të pensioneve bën që ata të dalin me dy pensione në fund dhe pensioni privat është më i favorshëm, sepse përfitimet janë më të larta.

Po kështu, punëmarrësi dhe punëdhënësi kanë përfitime nga favorët ligjore të mostaksimit të kontributeve.

Por këtu nuk përfiton vetëm punëmarrësi, por edhe punëdhënësi përfiton sepse i ulet tatimi mbi fitimin për kompaninë e tij, për shkak se kontributet për pension privat i llogariten punëdhënësit si pjesë e zbritshme.

Nga ana tjetër, kompanitë që vendosin që të kontribuojnë për stafin e tyre për pension privat, gjithashtu kanë benefite për efekt mostatimi.

PËR SHEMBULL, NËSE NJË PUNONJËS ME PAGË BRUTO 70 MIJË LEKË TË REJA NË MUJ DO TË VENDOSTE QË 5 MIJË LEKË T'I KONTRIBUONTE PËR VETE NË FONDIN PRIVAT TË PENSIONEVE, PAGA E TIJ DO TË TATOHEJ PËR 65 MIJË LEKË DHE JO MË PËR 70 MIJË LEKË, SEPSE NDALESA PËR PENSION PRIVAT NUK TATOHEJ. PËR PASOJË, TATIMI PËR PAGËN 70 MIJË DO TË ISHTE 5200 LEKË NË MUJ, NDËRSA PËR PAGESËN 65 MIJË TATIMI ËSHTË 4550 LEKË NË MUJ. SI REZULTAT PUNËMARRËSI FITON NË MUJ 650 LEKË OSE 7800 LEKË NË VIT.

NËSE DO TË MERRNIN SHEMBULLIN E PAGËS 100 MIJË LEKË TË REJA NË MUJ PËR NJË PUNONJËS, DHE AI/AJO VENDOS QË 10 MIJË LEKË T'I KONTRIBUOJË NË FONDIN PRIVAT TË PENSIONEVE, DO TË PËRFITONTE NGA MOSTATIMI I 10 MIJË LEKËSHIT 1300 LEKË NË MUJ OSE 15600 LEKË TË REJA NË VIT.

NDËRSA PËR ATA QË E KANË PAGËN 150 MIJË LEKË TË REJA NË MUJ DHE VENDOSIN TË DERDHI SI KONTRIBUT PËR PENSION PRIVAT 20 MIJË LEKË NË MUJ, PËRFITIMI QË DO TË KISHIN NË VIT ËSHTË 55200 LEKË TË REJA.

Për shembull, nëse një kompani me të ardhura vjetore 500 milionë lekë, me shpenzime vjetore 300 milionë lekë, vendos që 5 milionë lekë t'i investojë për stafin si pension privat, përfitimi që do të kishte nga tatimi mbi fitimin do të ishte 750 mijë lekë të reja.

Krijimi e zhvillimi i skemave private të pensioneve në Shqipëri është shumë efikas dhe për faktin e moshave të reja që ka popullsia e Shqipërisë 33-35 vjeç, kundrejt 48-50 vjeç që e ka Europa, ç'ka ekziston mundësia të përfitohet shumë nga investimi i tyre.

Shqipëria ka nevojë të hedhë tani themelet e një sistemi të diversifikuar pensionesh, ku rëndësi kritike kanë si pensionet publike ashtu edhe ato private, për të kontribuar në sigurinë financiare të vendit.

Pjesë kyçe e këtij sistemi janë sipërmarrjet private, e veçanërisht industria e sigurimeve private, e cila ka nevojë të rigjenerohet dhe të mbështetet nga shteti dhe jo vetëm t'i vilen taksat.



**AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS**

investo ně optimalizēm

www.abi.al